

URDHËR
Nr. 192, datë 8.5.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteri Skënder Gjoci, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1, datë 27.2.2013, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, për shkak se i biri i tij z. Alban Gjoci, është shpallur fitues në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit/ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t’i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 126, datë 28.3.2013, z. Alban Gjoci i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit, pranë bashkisë Kavajë.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Skënder Gjoci, për shkak të dorëheqjes së tij, si dhe dorëzimi i akteve dhe i regjistrave të tij noterialë të birit z. Alban Gjoci, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë bashkisë Kavajë.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në shkronjën “a” të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Skënder Gjoci, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës.

II. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Durrës.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noterit Alban Gjoci.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Skënder Gjoci, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë: institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e

shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi